BANKINGU QENDROR

AKTIVITETET KRYESORE TË BANKËS SË SHQIPËRISË

janar - qershor 2019



LAJME DHE NGJARJE NË 6 MUAJ

Nr. 05

WWW.BANKOFALBANIA.ORG

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z.Gent Sejko.

EDITORIAL

Të nderuar Lexues,

Kam kënaqësinë t'ju prezantoj me numrin e pestë të Revistës "Bankingu qendror: Lajme dhe ngjarje në 6 muaj", për gjashtëmujorin e parë të vitit 2019.

Kjo revistë sjell tek ju, në mënyrë kronologjike, të gjithë veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë gjatë këtyre gjashtë muajve, dhe pasqyron hapat që kemi ndjekur për të përmbushur objektivat kryesorë të saj, në mbështetje të zhvillimit ekonomik të vendit e rritjes së mirëqenies së përgjithshme të qytetarëve. Në këtë zhvillim dhe rritje kontribuojnë një sërë faktorësh, ku rol të pazëvendësueshëm luan kreditimi i ekonomisë dhe agjentëve të saj nga sektori bankar.

Kreditimi është instrumenti që "përkthen" kursimet e qytetarëve në fonde të disponueshme për financimin e ekonomisë. Ai mban një pozicion kyç në ciklin e biznesit dhe në ecurinë ekonomike të një vendi. Me përmirësimin e mjedisit ekonomik, sipërmarrjet dhe individët janë më të gatshëm të investojnë dhe të shpenzojnë, duke nxitur kështu kërkesën për kredi dhe duke krijuar një cikël të plotë: rritje ekonomike – projekte në zhvillim – kërkesë të shtuar për kredi – fitime më të larta.

Në Shqipëri, sektori bankar është shtyllë kryesore e sistemit financiar, falë kontributit të tij të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm në zhvillimin ekonomik të vendit. Aktualisht, ky sektor administron rreth 2.4 milionë llogari bankare të individëve dhe ofron kredi për rreth 327 mijë biznese të vogla apo të mëdha, si dhe për ente të tjera publike apo private. Në terma makroekonomikë, vëllimi i kredisë së dhënë prej këtij sektori është rreth 35% e PBB-së.

Sot, perspektiva e biznesit në vend tregon se ai ka një potencial të lartë për kreditim dhe me rrezik të reduktuar. Ndërkohë, përballë një mjedisi kompleks e dinamik që shpesh të vë përballë sfidave të ndërlidhura me zhvillime të paparashikueshme, të brendshme apo të jashtme, detyra e aktorëve dhe rregullatorëve të sektorit bankar është që së bashku të reagojmë në kohë dhe me vendosmëri, për rritjen e qëndrueshmërisë së sektorit bankar ndaj sfidave të mundshme, si dhe për t'i kthyer sfidat e identifikuara tashmë në oportunitete zhvillimi.

Nga ana e saj, Banka e Shqipërisë ka vepruar nëpërmjet instrumenteve të saj dhe ka marrë masat e nevojshme për të mundësuar krijimin e kushteve të favorshme të financimit.

Nxitja e kreditimit ka qenë në fokus të objektivave të Bankës së Shqipërisë në veprimtarinë e saj gjatë viteve të fundit. Së fundmi, ajo është angazhuar në hartimin e një plani masash, synimi i të cilit është të rigjallërojë procesin e kreditimit të shëndetshëm në vend. Ky plan masash u është dërguar për konsultim bankave tregtare në vend, në mënyrë që të gjithë aktorët e tregut të japin kontributin e tyre për të nxitur procesin e kreditimit.

Banka e Shqipërisë mbetet e gatshme të vijojë të mbështesë rritjen e mëtejshme të kreditimit, të ekonomisë sonë dhe të mirëqenies së qytetarëve tanë.

GUVERNATORI SEJKO NË FORUMIN PËR VENDET E EVROPËS QENDRORE DHE LINDORE TË ORGANIZUAR NGA "EUROMONEY"

15-16 janar 2019, Vjenë, Austri

Në datat 15-16 janar 2019, "Euromoney" organizoi Forumin për vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, në Vjenë, Austri. Ky forum zhvillohet çdo vit dhe mbledh në një tryezë të përbashkët diskutimi personalitete të njohura ndërkombëtare nga fusha politike, ekonomike e financiare nga vendet e EQL-së.

Punimet e këtij forumi dyditor ishin konceptuar në formën e paneleve me tema specifike, ku të pranishmit ishin të ftuar të diskutonin mbi zhvillimet më të fundit ekonomike në vendet e Evropës dhe më gjerë. Një rëndësi të veçantë në këtë organizim kishte paneli i guvernatorëve të vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore, kushtuar politikës monetare.

Gjatë zhvillimit të panelit në fjalë, Guvernatori Sejko bëri një ekspoze të situatës ekonomike dhe financiare shqiptare, duke theksuar se Shqipëria po përjeton një rimëkëmbje të qëndrueshme ciklike, me rritje të përshpejtuar gjatë tre viteve të fundit, duke e afruar ekonominë vendase drejt ekuilibrit. Gjithashtu, Guvernatori theksoi rëndësinë e vazhdimit të përpjekjeve për një integrim sa më të shpejtë të vendeve të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian, në funksion të përshpejtimit të ritmit të rritjes ekonomike, të rritjes së mirëqenies shoqërore, si dhe të ankorimit sa më të mirë të perspektivave afatgjata të zhvillimit të vendit.

ZËVENDËSGUVERNATORJA E DYTË AHMETAJ NË KONFERENCËN "BALANCIMI I MUNDËSIVE DHE RREZIQEVE FINTECH – ZBATIMI I AXHENDËS SË BALIT"

28-29 janar 2019, Vjenë, Austri

Në datat 28-29 janar 2019, Zëvendësguvernatorja e Dytë e Bankës së Shqipërisë, zj. Natasha Ahmetaj, mori

pjesë në konferencën me temë: "Balancimi i mundësive dhe rreziqeve Fintech -zbatimi i Axhendës së Balit", në Vjenë, Austri.

Në qendër të diskutimeve të kësaj konference ishte Axhenda e Balit mbi teknologjitë financiare, të njohura sot në botën financiare me termin Fintech. Kjo axhendë u prezantua në mbledhjet e vjeshtës të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore, në Bali, në tetor 2018, për të promovuar inovacionin teknologjik në sektorin e shërbimeve financiare.

Konferenca ishte e konceptuar në formën e sesioneve, ku një rëndësi të veçantë kishte sesioni me temë: "Përfshirja financiare, zhvillimi dhe rritja gjithëpërfshirëse", në të cilin bënte pjesë dhe Shqipëria.

Gjatë fjalës së saj, Zëvendësguvernatorja Ahmetaj u shpreh se Axhenda e Balit formon një matricë objektivash për t'u përmbushur dhe një udhëzues për rritjen e potencialit të ekonomisë së vendeve tona dhe si e tillë, ajo duhet zbatuar kombëtarisht. Por natyrisht, çdo standard duhet të përshtatet, duke reflektuar prioritetet e secilit vend, në mënyrë që zbatimi të jetë efektiv. Në rastin e Shqipërisë, ajo u shpreh se formalizmi i remitancave dhe përfshirja financiare përbëjnë dy elemente që kërkojnë vëmendje të veçantë për përmirësim të mëtejshëm. Për të dyja këto

elemente, ajo parashtroi gjithë iniciativat dhe hapat e ndërmarra nga Banka e Shqipërisë, për përmirësimin e kuadrit rregullator dhe zhvillimin e infrastrukturës teknologjike.

GUVERNATORI SEJKO NË MBLEDHJEN E KONSTITUENCËS TË FONDIT MONETAR NDËRKOMBËTAR DHE TË GRUPIT TË BANKËS BOTËRORE

15 shkurt 2019, Valletta, Maltë

Në datën 15 shkurt 2019, u zhvillua Mbledhja e Konstituencës të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe të Grupit të Bankës Botërore (BB), e cila u zhvillua në Valletta, Maltë. Ky takim mblodhi së bashku guvernatorët dhe ministrat e financave të vendeve anëtare të kësaj konstituence, për të diskutuar zhvillimet më të fundit të ekonomisë botërore dhe ekonomive përkatëse.

Banka e Shqipërisë u përfaqësua në këtë mbledhje nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, i cili, gjatë takimit, prezantoi zhvillimet më të fundit ekonomike në vend, duke theksuar rolin e rëndësishëm që luan Banka e Shqipërisë në zhvillimin ekonomik të tij. Politika monetare stimuluese e ndjekur nga banka qendrore ka dhënë një kontribut pozitiv në këtë drejtim.

Më tej, Guvernatori Sejko paraqiti pikëpamjet e Bankës së Shqipërisë mbi temat kryesore të diskutimit. Në këtë kuadër, ai theksoi se Banka e Shqipërisë mirëpret rishikimet periodike të shpërndarjes së kuotave dhe rritjen e kapitalit, të cilat synojnë përmbushjen e objektivave institucionale të Fondit. Guvernatori u ndal dhe në prioritetet e FMN-së dhe BB-së, si dhe në rolin e rëndësishëm të dy institucioneve në promovimin e rritjes ekonomike të qëndrueshme dhe afatgjatë të vendeve në zhvillim.

BANKA E SHQIPËRISË ZHVILLON CEREMONINË E PROMOVIMIT TË LIBRIT "PARAJA, BANKAT DHE SHOQËRIA"

22 shkurt 2019, Tiranë

Në datën 22 shkurt 2019, në ambientet e Bankës së Shqipërisë u zhvillua ceremonia e promovimit të librit "Paraja, bankat dhe shoqëria. Bashkudhëtimi historik që nga fillesat deri në kohët moderne", të autorëve Prof. Dr. Aristotel Pano dhe Akad. Prof. Dr. Anastas Angjeli.

Në fjalën e mbajtur me këtë rast, Guvernatori Sejko shprehu vlerësimet e tij për dy profesorët Pano dhe Angjeli, të cilët, përmes një gjuhe të thjeshtë e të qartë, kanë sjellë në duart e lexuesit një analizë të plotë të sistemeve monetare e financiare, të përshkruar në formën e një udhëtimi historik që nga lashtësia e deri në ditët tona.

Ky libër është një udhëtim historik e ekonomik në sistemet monetare që kanë mbisunduar dhe administruar jetën ekonomike e financiare globale, si dhe në vende apo territore shqiptare. Libri u nominua nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë për çmimin "Petrit Radovicka".

NËNSHKRUHET MEMORANDUMI I MIRËKUPTIMIT MIDIS SEKRETARIATIT TË SHTETIT ZVICERAN PËR ÇËSHTJET EKONOMIKE (SECO) DHE BANKËS SË SHQIPËRISË

1 mars 2019, Tiranë

Në datën 1 mars 2019, në ambientet e Bankës së Shqipërisë u zhvillua ceremonia e nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit midis Sekretariatit të Shtetit Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO) dhe Bankës së Shqipërisë, lidhur me zbatimin e fazës së dytë të programit të asistencës dypalëshe dhe zhvillimit të kapaciteteve për bankat qendrore për vitet 2018 – 2022. Marrëveshja u nënshkrua nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, dhe Ambasadori i Zvicrës në Shqipëri, SH.T.Z Adrian Maître.

Gjatë fjalës së tij, Guvernatori Sejko u shpreh se kjo marrëveshje vjen pas mbylljes së një bashkëpunimi të suksesshëm në periudhën 2013-2018, e cila solli dhe një përmirësim të dukshëm të punës analitike, kërkuese dhe teknike të Bankës së Shqipërisë. Në këtë kuadër, Guvernatori theksoi se rezultatet e këtij projekti bashkëpunimi kanë qenë frytdhënëse në fushën e zbatimit të politikës monetare, mbikëqyrjes bankare, stabilitetit financiar dhe sistemit të pagesave.

BANKA E SHQIPËRISË BËHET PJESË E AKTIVITETEVE TË SAMITIT II TË DIASPORËS SHQIPTARE

28 shkurt - 2 mars 2019, Tiranë

Në datat 28 shkurt - 2 mars 2019 zhvilloi punimet Samiti II i Diasporës Shqiptare. Ky aktivitet u organizua nga Qeveria Shqiptare, me pjesëmarrjen e personaliteteve shqiptare të biznesit, shkencës, artit e kulturës, të cilët jetojnë jashtë vendit.

Me ftesë të organizatorëve, në datë 1 mars 2019, Zëvendësguvernatorja e Parë e Bankës së Shqipërisë, zj. Luljeta Minxhozi,

mbajti një fjalë në panelin "Zhvillimi ekonomik i qëndrueshëm – Vendlindja dhe Diaspora". Në fjalën e saj, zj. Minxhozi u shpreh se diaspora shqiptare karakterizohet nga lidhja e fortë që ka me vendin e origjinës dhe kontributin e rëndësishëm që jep në rritjen ekonomike të vendit. Në këtë kuadër, ajo theksoi rolin e rëndësishëm që luajnë në ekonominë e vendit remintancat, dhe masat që po ndërmerren nga Banka e Shqipërisë për të nxitur dhe lehtësuar procesin e transferimit të remintancave në ekonominë vendase.

Banka e Shqipërisë ishte gjithashtu pjesë integrale e panairit të çelur në ambientet ku u mbajtën punimet e samitit, më 1 mars 2019, në Tiranë. Në stendën e Bankës së Shqipërisë u prezantuan botime periodike dhe joperiodike të Bankës, materiale numizmatike, si dhe dy filma me temë: "Roli dhe funksionet e BSH-së" dhe "Momentet kryesore të bankingut dhe historisë së Lekut në rreth 100 vite". Gjithashtu, në këtë aktivitet u prezantua edhe skulptura e Bankës së Shqipërisë dedikuar Diasporës. Faqja dhe shpina e kësaj skulpture janë konceptuar si dy pjesë që i japin kuptim njëra-tjetrës: në të parën ndjehet drama që ka brenda largimi; ndërsa në të dytën trajtohet tema e kthimit, një kthim idealist, me kontribute, me dashuri e me trashëgimi vlerash.

Stenda e Bankës së Shqipërisë ishte e hapur për publikun edhe në Lezhë, në datën 2 mars 2019, në ambientet e bibliotekës së qytetit, në kuadër të kremtimeve të 575-vjetorit të Besëlidhjes së Lezhës.

GUVERNATORI SEJKO NË KLUBIN E GUVERNATORËVE TË VENDEVE TË AZISË QENDRORE, RAJONIT TË DETIT TË ZI DHE TË BALLKANIT

25 - 26 mars 2019, Stamboll, Turqi

Në datat 25-26 mars 2019, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, mori pjesë në takimin e 41-të të Klubit të Guvernatorëve të vendeve të Azisë Qendrore, Rajonit të Detit të Zi dhe Ballkanit, zhvilluar në Stamboll, Turqi. Pjesëmarrës në takim qenë drejtues të bankave qendrore të vendeve anëtare të Klubit, si dhe përfaqësues të lartë të Fondit Monetar Ndërkombëtar, Bankës Qendrore Evropiane dhe Bankës për Rregullime Ndërkombëtare (BIS), si dhe akademikë të shquar. Aktiviteti u çel me fjalën përshëndetëse të Guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Turqisë, z. Murat Çetinkaya.

Në këtë aktivitet, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, mbajti një prezantim në panelin me temë "Komunikimi i bankës qendrore për rritjen e efektshmërisë

së politikave: forcimi i njohurive dhe ndërtimi i besimit".

Gjatë prezantimit, Guvernatori Sejko theksoi se ndërtimi i besimit të publikut te institucioni i bankës qendrore është një proces i gjatë dhe i vështirë, por rritja e transparencës dhe komunikimi i vazhdueshëm janë faktorë kyç për suksesin e këtij procesi. Në këtë kuadër, Banka e Shqipërisë i kushton një rëndësi të veçantë komunikimit të saj me publikun, jo vetëm për të përmbushur maksimalisht llogaridhënien e saj si institucion i pavarur, por edhe si një mjet për rritjen e efektivitetit të politikave të ndërmarra prej saj.

GUVERNATORI SEJKO NË TAKIMIN E KOMITETIT RAJONAL PËR EVROPËN TË ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARE TË SIGURUESVE TË DEPOZITAVE

4 prill 2019, Tiranë

Në datën 4 prill 2019, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, mori pjesë në takimin e Komitetit Rajonal për Evropën të Organizatës Ndërkombëtare

të Siguruesve të Depozitave, i organizuar nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave (ASD), në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare të Siguruesve të Depozitave (IADI), në ambientet e Bankës së Shqipërisë.

Në këtë takim merrnin pjesë përfaqësues nga Banka e Shqipërisë, Agjencia e Sigurimit të Depozitave, Organizata Ndërkombëtare e Siguruesve të Depozitave, si dhe sigurues nga vende të ndryshme të rajonit. Gjatë takimit, pjesëmarrësit diskutuan mbi rolin që luan Komiteti Rajonal për Evropën në lidhje me objektivat strategjikë të Organizatës Ndërkombëtare të Siguruesve të Depozitave, si dhe mbi gjetjen e alternativave të reja të financimit.

Në fjalën përshëndetëse të mbajtur në këtë takim, Guvernatori Sejko nënvizoi rëndësinë e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave në zhvillimin e një sistemi bankar të qëndrueshëm dhe të sigurt. Banka e Shqipërisë është jo vetëm autoriteti mbikëqyrës i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, por ka dhënë ndihmesën e saj në ngritjen e kësaj agjencie, me qëllim rritjen e besimit të publikut në sistemin bankar. Më tej, Guvernatori Sejko, duke iu referuar zhvillimeve financiare botërore, theksoi rolin e rëndësishëm të siguruesve të depozitave në parandalimin dhe administrimin e krizave financiare. Një skemë e mirëndërtuar e garantimit të depozitave ndikon në zbutjen e efekteve negative të krizës financiare, çka u vërtetua dhe në krizën e fundit financiare globale.

GUVERNATORI SEJKO TAKOHET ME DELEGACIONIN E BANKËS BOTËRORE

8 prill dhe 19 qershor 2019, Tiranë

Në datën 8 prill 2019, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, zhvilloi një takim me delegacionin e Bankës Botërore, të kryesuar nga zj. Maryam Salim, Përfaqësuese e Përhershme e Zyrës së Bankës Botërore në Shqipëri. Takimi u zhvillua në kuadër të projekteve të instrumentit të Bankës Botërore "Kredia për Politikën e Zhvillimit (Development Policy Loan)", i cili po mbështet Bankën e Shqipërisë për hartimin e ligjit të shërbimeve të pagesave dhe zhvillimin e aspekteve rregullative për zgjidhjen e kredive me probleme jashtë gjyqësorit.

Gjatë këtij takimi, Guvernatori Sejko prezantoi zhvillimet më të fundit ekonomike në vend, duke theksuar kontributin që jep Banka e Shqipërisë në zhvillimin e mëtejshëm ekonomik të vendit. Në këtë fushë, një nga çështjet e diskutuara ka qenë dhe zhvillimi i kuadrit rregullativ mbështetës për zgjidhjen jashtëgjyqësore të kredimarrësve me probleme në disa banka. Guvernatori Sejko njohu delegacionin edhe me punën e realizuar nga Banka e Shqipërisë për hartimin e projektligjit "Për shërbimet e pagesave", i cili synon të përafrojë një direktivë të rëndësishme evropiane në fushën e pagesave.

Gjithashtu, në datën 19 qershor 2019, Guvernatori Sejko zhvilloi një tjetër takim me Misionin e Bankës Botërore në kuadrin e Mbështetjes së Politikave Makrofiskale. Gjatë këtij takimi, përfaqësuesit e Misionit të Bankës Botërore i fokusuan diskutimet në fushën e politikave fiskale, në kuadër të programit në proces të mbështetjes buxhetore, si dhe në fushën e zhvillimit të sistemit financiar.

Gjatë këtij takimi, Guvernatori Sejko theksoi se Banka e Shqipërisë ka mbështetur dhe vijon të mbështesë konsolidimin fiskal, si një proces i cili ndihmon rritjen e qëndrueshmërisë ekonomike dhe financiare të vendit. Gjithashtu, ai theksoi rolin pozitiv që koordinimi i politikave monetare e fiskale ka në rritjen e efektivitetit dhe në krijimin e parakushteve për zhvillimin e qëndrueshëm dhe afatgjatë të vendit.

Në mbyllje, të pranishmit identifikuan disa fusha potenciale bashkëpunimi në të ardhmen, si përmirësimi i rregulloreve mbi vlerësimin e kolateralit dhe programe të mundshme të Bankës Botërore në interes të reduktimit të rrezikut të kreditit në vend.

MBLIDHET GRUPI KËSHILLIMOR I STABILITETIT FINANCIAR

9 prill 2019, Tiranë

Në datën 9 prill 2019, u zhvillua mbledhja e Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar (GKSF). Në këtë mbledhje të drejtuar nga Ministrja e Financave dhe Ekonomisë, morën pjesë Guvernatori i Bankës së Shqipërisë (BSH), Kryetari i Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF), Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Sigurimit të

Depozitave (ASD), si edhe përfaqësues të tjerë të këtyre institucioneve.

Në prezantimin e Bankës së Shqipërisë, me fokus tek vlerësimi i gjendjes financiare të sektorit bankar, u theksua se gjatë 2018-ës zhvillimet ishin përgjithësisht pozitive. Tregjet financiare funksionuan normalisht, ku vëllimet e transaksioneve mbetën të qëndrueshme dhe normat e interesit mbetën në nivele të ulëta. Veprimtaria e sektorit bankar u zgjerua, pavarësisht efektit statistikor pakësues që dha mbiçmimi i kursit të këmbimit të lekut. Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rreziqeve të veprimtarisë, ishte i kontrolluar. Kreditë me probleme u pakësuan me gati 15 miliardë lekë, duke bërë që raporti i kredive me probleme të bjerë në nivelin 11.1%. Në rënien e këtij treguesi është forcuar ndikimi që vjen nga shlyerjet, duke kontribuuar pozitivisht në rritjen e qëndrueshmërisë së prirjes rënëse të kredive me probleme.

Më tej, anëtarët e GKSF-së diskutuan mbi nevojën për identifikimin e veprimeve që synojnë rritjen graduale të përdorimit të monedhës vendase në sektorin real të ekonomisë. Diskutimi evidentoi rëndësinë që ky hap paraqet për suksesin e objektivit mbi rritjen e përgjithshme të përdorimit të lekut në sistemin financiar dhe ekonominë shqiptare. Në zbatim të strategjisë përkatëse ndërinstitucionale, përfaqësuesit e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë u angazhuan ta trajtojnë me përparësi këtë çështje.

GUVERNATORI SEJKO NË MBLEDHJET E PRANVERËS TË FONDIT MONETAR NDËRKOMBËTAR DHE BANKËS BOTËRORE

12-14 prill 2019, Uashington, SHBA

Në datat 12-14 prill 2019, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, mori pjesë në Mbledhjet e Pranverës të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe të Grupit

të Bankës Botërore (BB), në Uashington. Gjatë pjesëmarrjes në këto mbledhje, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Sejko, zhvilloi disa takime të rëndësishme me personalitete të njohura të fushës financiare ndërkombëtare.

Gjatë takimeve në fjalë, Guvernatori Sejko prezantoi zhvillimet më të fundit ekonomike në vend, duke u ndalur në perspektivën e rritjes ekonomike dhe në zhvillimet e sektorit bankar. Rritja ekonomike e vendit ka vazhduar trendin pozitiv të saj, mbështetur dhe nga politika monetare stimuluese e Bankës së Shqipërisë. Ky stimul i transmetuar nëpërmjet normave të ulëta të interesit dhe komunikimit të kahut të ardhshëm të politikës monetare, ka qenë i përshtatshëm për nxitjen e zhvillimit ekonomik, stabilitetin e tregjeve dhe për kthimin e inflacionit në objektiv.

Më tej, Guvernatori Sejko paraqiti masat e ndërmarra nga Banka e Shqipërisë për të garantuar një sektor bankar të qëndrueshëm, likuid dhe të mirëkapitalizuar. Aktualisht, ky sektor përshkoi një fazë ristrukturimi, me futjen e aktorëve të rinj dhe bashkimin e disa bankave. Guvernatori nënvizoi se këto ndryshime janë kryer në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe Banka e Shqipërisë mbetet e angazhuar të ushtrojë një mbikëqyrje të kujdesshme për një veprimtari të shëndetshme bankare. Ristrukturimi i sektorit bankar është zhvillim pozitiv, i cili pritet të ndihmojë në rritjen e konkurrencës dhe krijimin e kushteve të

nevojshme për nxitjen e ritmit të kreditimit në vend.

Në përfundim të takimeve, përfaqësuesit e institucioneve ndërkombëtare përgëzuan Bankën e Shqipërisë për kontributin e saj në zhvillimin makroekonomik të vendit dhe stabilitetin financiar të tij. Ata theksuan se Banka e Shqipërisë duhet të vazhdojë hapat e ndërmarrë lidhur me planin e masave për

reduktimin e kredive me probleme, nxitjen e kreditimit dhe stimulimin e përdorimit të monedhës kombëtare.

Gjithashtu, përfaqësuesit e FMN-BB-së theksuan rëndësinë e bashkërendimit në vazhdimësi të politikës monetare me atë fiskale. Ky bashkërendim ndihmon në forcimin e stabilitetit makroekonomik të vendit dhe rritjen ekonomike afatgjatë.

GUVERNATORI SEJKO PREZANTON RAPORTIN VJETOR TË BANKËS SË SHQIPËRISË PËR VITIN 2018

23 prill 2019, Tiranë

Në datë 23 prill 2019, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, prezantoi përpara deputetëve të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave (KEF), Raportin Vjetor të Bankës së Shqipërisë për vitin 2018. Ndërsa në datën 8 maj 2019, Guvernatori Sejko e prezantoi këtë Raport përpara deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë. Raportimi në Kuvendin e Shqipërisë përbën instrumentin kryesor llogaridhënës të Bankës së Shqipërisë si institucion i pavarur.

Gjatë fjalës së tij, Guvernatori Sejko bëri një ekspoze të panoramës ekonomike e

financiare të vendit, në të cilën theksoi se viti 2018 ka qenë një vit progresi për ekonominë dhe për sistemin financiar shqiptar. Më konkretisht, Guvernatori u ndal në kontributin që Banka e Shqipërisë ka dhënë në vitin 2018, nëpërmjet:

- zbatimit të një politike monetare stimuluese, e cila ka nxitur rritjen ekonomike dhe kthimin e inflacionit në objektiv, si dhe ka ndihmuar përmirësimin e bilanceve të biznesit, familjeve, sektorit publik dhe institucioneve financiare të vendit;
- forcimit dhe përmirësimit në kuadrin politik, rregullator e operacional, të mbikëqyrjes së sektorit bankar, duke u kujdesur njëkohësisht për administrimin e procesit të konsolidimit të tij, si dhe rritjes së sigurisë së sistemit bankar, përmes ngritjes së strukturave të specializuara për të administruar ndërhyrjet e ristrukturimet e nevojshme tek bankat me vështirësi paguese;
- krijimit të incentivave për zhvillimin e sistemit të pagesave dhe zgjerimin e thellimin e tregut financiar.

Më tej, Guvernatori shtoi se Banka e Shqipërisë ka punuar intensivisht për përvetësimin e standardeve dhe praktikave më të mira të bankingut qendror. Gjithashtu, ajo ka bërë progres në përmirësimin e statistikave, punës kërkimore, plotësimit të kritereve të integrimit të vendit në Bashkimin Evropian, forcimit të qeverisjes së institucionit, si dhe në shumë drejtime të tjera.

Në përfundim të fjalës së tij, Guvernatori garantoi se Banka e Shqipërisë do të vijojë të mbetet një institucion i përkushtuar në respektimin e objektivave të tij ligjorë.

GUVERNATORI SEJKO TAKOHET ME MISIONIN E FONDIT MONETAR NDËRKOMBËTAR

25 prill 2019, Tiranë

Më datë 25 prill 2019, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, zhvilloi një takim me misionin e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), të kryesuar nga z. Jan Kees Martijn, Shef i Misionit për Shqipërinë. Ky takim u zhvillua në kuadër të diskutimeve për Artikullin IV me misionin e FMN-së në vendin tonë.

Çështjet e diskutuara gjatë këtij takimi ishin: zhvillimet makroekonomike, pritshmëritë për vitin 2019 dhe periudhën afatmesme, faktorët e rritjes ekonomike; inflacioni dhe parashikimet për kthimin e inflacionit në objektiv; kursi i këmbimit dhe ecuria e tij; tregjet financiare; sistemi bankar, konsolidimi i tij dhe treguesit financiarë, mbikëqyrja bankare; ecuria e kreditimit dhe parashikimet për vitin 2019; kreditë me probleme, zbatimi i planit ndërinstitucional për reduktimin e tyre dhe masat që po ndërmerren në këtë drejtim, pritshmëritë për 2019-ën; paketa e deeuroizimit dhe masat përkatëse; modernizimi i sistemeve të pagesave.

GUVERNATORI SEJKO NË KONFERENCËN E 3TË TË SHOQATËS SHQIPTARE TË BANKAVE

14 maj 2019, Tiranë

Në datën 14 maj 2019, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, mori pjesë në konferencën e tretë të Shoqatës Shqiptare të Bankave (SHSHB), me temë: "Bankat për zhvillim të qëndrueshëm", të organizuar me rastin e 20-vjetorit të krijimit të SHSHB-së në Shqipëri.

Në fjalën përshëndetëse, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, vlerësoi rolin koordinues të SHSHB-së në industrinë bankare, si dhe progresin e konsiderueshëm të sistemit bankar në Shqipëri gjatë dy dekadave të fundit. Ai theksoi se zhvillimi i sektorit bankar dhe i sistemit financiar në përgjithësi është përballur me sfida të formave dhe përmasave të ndryshme. Këto sfida kanë kërkuar kujdes dhe vendimmarrje aktive, inteligjente e kurajoze.

Në përfundim, Guvernatori Sejko shprehu bindjen se sektori bankar do të dijë të ngrihet në lartësinë e këtyre sfidave dhe se konkluzionet e konferencës do të shërbejnë për të reflektuar më tej në këtë drejtim.

BANKA E SHQIPËRISË BËHET PJESË E PROGRAMIT TË ASISTENCËS TEKNIKE ME BANKAT QENDRORE TË SISTEMIT EVROPIAN TË BANKAVE QENDRORE

14 maj 2019, Tiranë, Shqipëri

Për dy vitet e ardhshme, Banka e Shqipërisë do të jetë pjesë e programit të asistencës teknike të përgatitur nga Deutsche Bundesbank (Banka Qendrore e Gjermanisë), së bashku me 17 banka qendrore kombëtare të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore (SEBQ) dhe Bankën Qendrore Evropiane (BQE), për bankat qendrore dhe institucionet mbikëqyrëse të vendeve të Ballkanit Perëndimor, kandidate dhe kandidate potenciale për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Ky program do të zbatohet me fondet e akorduara dhe monitoruara nga Bashkimi Evropian në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA II).

Banka e Shqipërisë do të përfitojë asistencë teknike nga zbatimi i këtij programi, së bashku me Bankën Qendrore të Bosnje-Hercegovinës, Agjencinë Bankare të Federatës së Bosnje-Hercegovinës, Agjencinë Bankare të Republikës së Serbisë, Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, Bankën Qendrore të Malit të Zi, Bankën Kombëtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Bankën Kombëtare të Serbisë.

Ky program synon forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve të institucioneve përfituese, kryesisht përmes përmirësimit të mëtejshëm të instrumenteve të tyre analitike dhe politike, nëpërmjet përvetësimit të standardeve më të mira ndërkombëtare dhe evropiane në praktikat kombëtare.

INTERVISTË E GUVERNATORIT SEJKO PËR REVISTËN MONITOR

20 maj 2019, Tiranë, Shqipëri

Në një intervistë për revistën ekonomike Monitor, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, shprehet referuar informacionit të disponuar, analizave dhe modeleve të parashikimit, se ekonomia shqiptare sugjerohet të vijojë të rritet në horizontin afatmesëm e afatgjatë.

Gjatë intervistës, Guvernatori u shpreh lidhur me politikën e deeuroizimit, duke theksuar se, në tërësi, vlerat e treguesve të përdorimit të monedhës euro mbeten të shmangura nga vlerat mesatare të treguesve për vende me ekonomi të ngjashme si Shqipëria. Ndaj, të gjithë duhet të jemi të vetëdijshëm që përpjekja për rritjen e përdorimit të monedhës kombëtare në sistemin financiar dhe në ekonominë shqiptare, përfaqëson një proces afatgjatë

për të cilin duhet punuar në mënyrë të koordinuar dhe në vijimësi.

Më tej, Guvernatori u shpreh lidhur me zhvillimet e rëndësishme në sektorin bankar, të cilat paraqesin sfida, kanë implikime në strukturën e sistemit bankar, aspektet konkurruese të tij dhe profilin e pronësisë së bankave të reja. Shkrirjet dhe bashkimet e ndodhura ndërmjet bankave ekzistuese, ku dominojnë dukshëm bankat e grupit të mesëm, sipas mendimit tonë premtojnë një konkurrencë të shtuar në treg, përmirësim të efektivitetit të veprimtarisë bankare dhe për pasojë, edhe rritje të cilësisë së shërbimeve dhe produkteve bankare.

Në përfundim, ai shtoi se konsolidimi që po përjetojmë shënoi një hap pozitiv në historinë e bankingut shqiptar dhe dëshmoi njëkohësisht se ka interes nga aktorë të ndryshëm drejt tregut vendas.

GUVERNATORI SEJKO NË TAKIM DISKUTIMI ME SEKTORIN BANKAR

29 maj 2019, Tiranë, Shqipëri

Në datën 29 maj 2019, në ambientet e Bankës Shqipërisë u zhvillua takimi me temë: "Sektori bankar si kontribuues i rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të vendit". I kthyer tashmë në një traditë, ky takim ka për qëllim forcimin e mëtejshëm të marrëdhënies së bashkëpunimit me sistemin bankar. Në këtë takim të organizuar me iniciativën dhe nën drejtimin e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, morën pjesë drejtues të Bankës së Shqipërisë, përfaqësuesit ekzekutivë më të lartë të bankave tregtare (drejtorë të përgjithshëm dhe zëvendësit e tyre), si dhe përfaqësues nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore.

Gjatë fjalës së tij, Guvernatori vlerësoi kontributin e rëndësishëm që sektori bankar jep në zhvillimin ekonomik të vendit, ku vëllimi i kursimeve financiare të administruara nga sektori bankar zë rreth 70% të PBB-së, ndërsa vëllimi i kredisë së dhënë prej tij është rreth 35% të PBB-së. Në gjykimin e Bankës së Shqipërisë, sektori bankar është shtylla kryesore e sistemit financiar dhe njëkohësisht ndër segmentet më të zhvilluara dhe profesionale të ekonomisë.

Në mbyllje të fjalës së tij, Guvernatori Sejko u shpreh se një tjetër rol i rëndësishëm i sektorit bankar është sigurimi i shërbimeve të pagesave në ekonomi. Ai theksoi se për të përmirësuar tregun e pagesave me vlerë të vogël, Banka e Shqipërisë ka hartuar projektligjin "Për shërbimet e pagesave", me miratimin e të cilit do të krijohen kushtet për promovimin e risive teknologjike, duke nxitur prezantimin e instrumenteve më efikase, më të shpejta dhe me kosto më të ulët, të cilat do të rrisin konkurrencën në treg, si dhe do të sigurojnë transparencë dhe mbi të gjitha mbrojtje për konsumatorin.

GUVERNATORI SEJKO MERR PJESË NË SAMITIN E VENDEVE TË RAJONIT

13-15 qershor 2019, Becic, Mal i Zi

Në datat 13-15 qershor 2019, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, mori pjesë në Samitin Vjetor të Vendeve të Rajonit të mbajtur në Becic, Mal i Zi, bashkë me guvernatorë e përfaqësues të lartë të bankave qendrore, ministra financash dhe drejtorë tatimesh nga vendet e rajonit, si Bosnje-Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Kroacia, Kosova dhe Shqipëria. Në samitin e këtij viti me temë "Stabiliteti financiar dhe monetar në rajon në një mjedis me rritje të ngadalësuar në Eurozonë", pjesëmarrësit u angazhuan në diskutime mbi zhvillimet më të fundit ekonomike në vendet e rajonit.

Gjatë fjalës së tij mbajtur në panelin e guvernatorëve, ku u diskutua rreth temës "Politika monetare dhe stabiliteti i sistemit bankar në kushtet e normave të ulëta të inflacionit dhe të interesave", Guvernatori njohu të pranishmit me ecurinë ekonomike e financiare të vendit, si dhe sfidat me të cilat po përballet Banka e Shqipërisë. Ai theksoi rëndësinë e harmonizimit të politikës fiskale me atë monetare, si parakusht i nevojshëm për stabilitetin ekonomik dhe financiar të vendit, si dhe rritjen e efektivitetit të këtyre politikave.

Më tej, Guvernatori bëri një ekspoze të sfidave të reja me të cilat përballen sot bankat qendrore, ku ndër më kryesoret është mbështetja e procesit të integrimit në Bashkimin Evropian, nëpërmjet përafrimit të politikave dhe praktikave të brendshme me ato të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore (SEBQ).

GUVERNATORI SEJKO NË KONFERENCËN E 8-TË TË BANKËS QENDRORE EVROPIANE PËR VENDET E EVROPËS QENDRORE LINDORE DHE JUGLINDORE

12 qershor 2019, Frankfurt, Gjermani

Në datë 12 qershor 2019, Guvernatori Sejko mori pjesë edhe në Konferencën e 8-të të Bankës Qendrore Evropiane për vendet e Evropës Qendrore Lindore dhe Juglindore (EQLJL), me temë "Qëndrueshmëria ndaj zhvillimeve të pafavorshme globale? Reagimet e vendeve të EQLJL-së ndaj ndryshimeve në kontekstin tregtar dhe financiar", mbajtur në Frankfurt, Gjermani. E konceptuar në dy sesione dhe me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të lartë të BQE-së, guvernatorëve të bankave qendrore të vendeve të EQLJL-së, si dhe ekspertëve të sektorit bankar dhe financiar, konferenca trajtoi sfidat e këtij rajoni në përgjigje të tronditjeve tregtare dhe reagimin e politikës monetare ndaj tronditjeve financiare.

Gjatë diskutimeve të konferencës, Guvernatori Sejko, në ndërhyrjen e tij mbi eksperiencën e Shqipërisë ndaj sfidave aktuale, theksoi rëndësinë e kreditimit të ekonomisë, një proces i cili duhet mbështetur nga sektori bankar dhe më gjerë. Ai u shpreh se rezultatet pozitive të planit ndërinstitucional për uljen e kredive me probleme dhe konsolidimi i sektorit bankar janë faktorë të rëndësishëm që i japin frymëmarrjen e nevojshme ndërmjetësimit financiar të ekonomisë.

TË TJERA

BANKA E SHQIPËRISË I KOMUNIKON PUBLIKUT VENDIMMARRJEN E POLITIKËS MONETARE

Pas çdo mbledhjeje të Këshillit Mbikëqyrës, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë i komunikon publikut vendimmarrjen e Bankës së Shqipërisë, në një konferencë për shtyp.

Sipas kalendarit të publikuar në fillim të vitit, gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2019, janë zhvilluar tre konferenca për shtyp të Guvernatorit mbi këtë vendimmarrje, përkatësisht më: 6 shkurt, 28 mars, dhe 8 maj.

Gjatë këtyre konferencave, Guvernatori i komunikoi publikut të gjerë vendimet e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë lidhur me mbajtjen të pandryshuar të normës bazë të interesit, në nivelin 1.00%, si dhe të normës së interesit të depozitës njëditore, në nivelin 0.10% dhe të normës së interesit të kredisë njëditore në nivelin 1.90%.



Në deklaratat e tij, Guvernatori ka komunikuar edhe qëndrimin e ardhshëm të politikës monetare, duke u shprehur se "...Këshilli Mbikëqyrës vlerëson se politika monetare do të vijojë të mbetet stimuluese edhe gjatë horizontit afatmesëm. Në çdo rast, intensiteti i stimulit do të përshtatet me shpejtësinë dhe qëndrueshmërinë e përmirësimit të aktivitetit ekonomik, ndërkohë që Banka e Shqipërisë mbetet e gatshme të reagojë ndaj goditjeve të mundshme."

Banka e Shqipërisë mbetet e gatshme të reagojë ndaj goditjeve të mundshme, me qëllim sigurimin e arritjes së objektivit të inflacionit.

PREZANTIMET PËR MEDIAN TË RAPORTEVE PERIODIKE TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Si pjesë e strategjisë së saj të komunikimit me publikun, Banka e Shqipërisë organizon prezantimin e raporteve të saj periodike për median përpara publikimit të tyre. Bazuar në kalendarin e publikimit të raporteve periodike të publikuar në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë në fillim të vitit 2019, gjatë 6-mujorit të parë të këtij viti, janë zhvilluar 4 prezantime "*off the records*" për mediat:

- prezantimi i Raportit tremujor të Politikës Monetare 2019/I, në datën 14 shkurt 2019, në ambientet e Bankës së Shqipërisë;
- prezantimi i Raportit të Stabilitetit Financiar 6M II 2018, në datën 26 prill 2019, në ambientet e Bankës së Shqipërisë;

- prezantimi i Raportit tremujor të Politikës Monetare 2019/II, në datën 16 maj 2019, në ambientet e Bankës së Shqipërisë;

- prezantimi i Raportit Vjetor të Mbikëqyrjes për vitin 2018, në datën 20 qershor 2019, në ambientet e Bankës së Shqipërisë.

BANKA E SHQIPËRISË HEDH NË QARKULLIM MONEDHËN METALIKE SHQIPTARE ME KURS LIGJOR, ME VLERË NOMINALE 10 LEKË, EMETIM I VITIT 2018

Duke filluar nga data 25 qershor 2019, Banka e Shqipërisë hedh në qarkullim monedhën metalike shqiptare me vlerë nominale 10 Lekë, me kurs ligjor, emetim i vitit 2018.

Monedha e re metalike, me vlerë nominale 10 Lekë, emetim i vitit 2018, ka të njëjtën përbërje, pamje, përmasa dhe peshë me monedhën metalike me vlerë nominale 10 Lekë, emetim i vitit 2013. Ndryshimi nga emetimi i fundit qëndron tek viti i emetimit i shtypur në trupin e monedhës metalike, i cili në monedhën e re do të jetë "2018", si dhe drejtshkrimi i fjalëve "LEKË", dhe "SHQIPËRISË".

Kjo monedhë do të përdoret si mjet pagese paralelisht me të gjitha monedhat metalike ekzistuese në qarkullim të kësaj prerjeje, emetime të viteve të mëparshme.

SEMINARET E TË PREMTES

Banka e Shqipërisë organizon rregullisht aktivitetin me natyrë kërkimore "Seminari i të Premtes". Kjo nismë fton punonjësit e Bankës së Shqipërisë, kërkuesit e sferës akademike dhe të institucioneve të tjera financiare dhe kërkimore të prezantojnë dhe të diskutojnë materialet e tyre kërkimore, teorike dhe empirike. Gjatë gjashtëmujorit të parë u prezantuan këto punime:

- "Çfarë i shtyn luhatjet e kursit të këmbimit lekë - euro?", nga z. Altin Tanku dhe z. Ilir Vika, më datë 19 prill 2019.
- "*Sectoral accounts and balance sheets: policy uses of sectoral accounts*", nga z. John Joyce, ekspert i FMN-së, më datë 26 prill 2019;
- "*The effect of net income shocks on firm behavior: A variance decomposition approach to firm level data*", me autorë: Indrit Hoxha , Edward Hoang (University of Colorado, Colorado Springs), më datë 30 maj 2019.

AKTIVITETET E BANKËS SË SHQIPËRISË

KREMTOHET JAVA E PARASË

26 mars 2019, Tiranë

Në datat 25 – 31 mars 2019, Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me Shoqatën Shqiptare të Bankave dhe me mbështetjen e

Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe partnerëve të tjerë, organizoi për të gjashtin vit radhazi Aktivitetin e Javës së Parasë.

Kjo Javë është një festë mbarëbotërore e parasë, e cila ka për qëllim ndërgjegjësimin e brezit të ri për të qenë në të ardhmen qytetarë të përgjegjshëm dhe të aftë për të marrë vendime financiare të mirëmenduara.

Në aktivitetin çelës të Javës së Parasë 2019, Zëvendësguvernatorja e Parë e Bankës së Shqipërisë, zj. Luljeta Minxhozi, theksoi se viti 2019 shënon vitin e 12 të përfshirjes të Bankës së Shqipërisë në përpjekjen për edukimin financiar të publikut në përgjithësi, me fokus të veçantë tek më të rinjtë. Ajo shtoi se ky angazhim i Bankës së Shqipërisë përputhet plotësisht me frymën e transparencës ndaj publikut e të rritjes së nivelit të ndërgjegjësimit të tij mbi çështje ekonomike e financiare që ndikojnë në jetën e përditshme të gjithsecilit.

Zj. Minxhozi nënvizoi gjithashtu moton e aktivitetit "Tepër i ri për të folur me Lekë të vjetër!", duke adresuar një çështje specifike për vendin tonë, siç është përdorimi i gabuar, prej më shumë se 5 dekadash, i termave "lek i ri" dhe "lek i vjetër" në marrëdhëniet tona të përditshme financiare.

Më tej, aktiviteti vijoi me ceremoninë e ndarjes së çmimeve për fituesit e tre konkurseve të organizuara nga Banka e Shqipërisë dhe Shoqata Shqiptare e Bankave me rastin e Javës së Parasë, me pjesëmarrjen e rreth 340 nxënësve nga 40 shkolla të ndryshme 9-vjeçare dhe gjimnaze.

LEKSION I HAPUR I GUVERNATORIT SEJKO NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU", NË KUADËR TË "JAVËS SË PARASË"

29 mars 2019, Durrës, Shqipëri

Në datë 29 mars 2019, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, me ftesë të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës mbajti një leksion të hapur për një audiencë të gjerë studentësh me temë "Roli i Bankës së Shqipërisë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe afatgjatë të vendit – stabiliteti financiar, një parakusht i domosdoshëm në zhvillimin ekonomik".

Ky leksion u organizua në kuadër të Javës së Parasë 2019, përgjatë së cilës Banka e Shqipërisë organizon një sërë aktivitetesh me karakter edukativ për nxënës dhe studentë në të gjithë vendin.

Gjatë leksionit, Guvernatori njohu studentët me mënyrën se si Banka e Shqipërisë, krahas objektivit të saj kryesor për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve përmes ushtrimit të politikës monetare, i ka dhënë përparësi edhe objektivave që lidhen me stabilitetin financiar, përmes forcimit të procesit tradicional mbikëqyrës të veprimtarisë bankare dhe sipërmarrjes së një roli parësor në ushtrimin e politikës makroprudenciale.

Leksioni u mbyll me një sesion pyetje-përgjigjesh, ku Guvernatori iu përgjigj interesit të studentëve mbi çështje të bankingut qendror dhe me gjerë.

AKTIVITETET SOCIALE TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Banka e Shqipërisë, në kuadër të përpjekjeve për përgjegjësi përherë e më të lartë sociale,

ndërmerr vazhdimisht nisma të ndryshme humanitare.

Gjatë kësaj periudhe, me rastin e 14 Qershorit, "Ditës Botërore të Dhurimit të Gjakut", punonjës të shumtë Bankës së Shqipërisë iu bashkuan nismës së dhurimit vullnetar të gjakut.

Me rastin e 1 Qershorit, "Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve", punonjësit e Bankës së Shqipërisë i erdhën në ndihmë fëmijëve me aftësi të kufizuara të "Qendrës Lira", në Berat. Ata dhanë kontributin e tyre vullnetar duke dhuruar veshje, lodra, apo çdo lloj kontributi tjetër përfshirë atë monetar, për përmirësimin e mirëqenies dhe edukimit të fëmijëve të kësaj qendre.